

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4694/1 datë 03.11.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4697/3 datë 05.11.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 17-të mbajtur më 5.11.2025, miratoi si vijon:

**Aktvendim
për paralajmërim publik dhe për përjashtim nga ritransmetimi të shërbimeve programore**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHA eksport-import Shkup, për shkak se ka ritransmetuar shërbime programore që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në përputhje me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4694/1 datë 03.11.2025., që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHA eksport-import Shkup, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, përkatësisht të përjashtojë ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe përjashtim nga ritransmetimi të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi nuk veproi sipas aktvendimit përkatësisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LShMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në përputhje me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LShMAAV, ndërmerr masa në përputhje me ligjin në rastet ku është kryer shkelja e dispozitave të LShMAAV ose rregulloreve të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LShMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore dhe në përputhje me nenin 27 dhe nenin 28 të LShMAAV, Agjencia me datë 31.10.2025., ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore në paketën programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHA eksport-import Shkup, ku u konstatua se operatori në fjalë që sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 31.10.202., për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbime programore që nuk përfshihen në çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi (13) të LShMAAV.

Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar në detaje në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4694/1 datë 03.11.2025., që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LShMAAV dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4694/1 datë 03.11.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4697/3 datë 05.11.2025., për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LShMAAV cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin ndaj subjektit në fjalë të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, në mënyrë që të përjashton ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhërit, përkatësisht pas paralajmërimit publik ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në përputhje me nenin 24 të LShMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për iniciim të kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontesti administrativ ngrihet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4694/1 datë 03.11.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.